



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA KOMERCIALE

Numri i lëndës: 2024:024557

Datë: 07.02.2024

Numri i dokumentit: 05295072

KE.nr.349/22

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS, Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike, Gjyqtari Florent Zeqiri, në çështjen juridike të paditësit Xh.S. nga Mitrovica, që sipas autorizimit përfaqësohet nga avokat L.A. nga Mitrovica, kundër të paditurës N.N.T “B&B”, me nr. të biznesit 70859963 dhe me seli në Mitrovicë, fshati Zhabar i Poshtëm, me objekt kontesti kompensim dëmi, jashtë seancës me datën 07.02.2024, merr këtë:

A K T V E N D I M

- I. Gjykata Komerciale e Kosovës, Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike, shpallet JO KOMPETENTE në pikëpamje lëndore për të vendosur sipas padisë së paditësit Xh.S. nga Mitrovica, kundër të paditurës N.N.T “B&B”, me seli në Mitrovicë, me objekt kontesti kompensim dëmi, lënda e identifikuar me shenjën KE.nr.349/22.
- II. Pas plotfuqishmërisë së këtij aktvendimi lënda së bashku me shkresat e saj i dërgohet Gjykatës Themelore në Mitrovicë – Departamenti i Përgjithshëm.

A r s y e t i m

Paditësi Xh.S. nga Mitrovica me datë 18.03.2019, ka paraqitur padi pranë Gjykatës Themelore në Mitrovicë, kundër të paditurës N.N.T “B&B”, me seli në Mitrovicë, me objekt kontesti kompensim dëmi.

Lënda në fjalë, fillimisht është regjistruar me shenjën C.nr. 158/19, ndërsa pas hyrjes në fuqi të Ligjit nr. 08/L-015 për Gjykatën Komerciale, është transferuar për shqyrtim në Gjykatën Komerciale të Kosovës dhe ka marrë numrin KE.nr. 349/22.

Gjykata, gjatë shqyrtimit paraprak të padisë dhe shkresave të lëndës në përputhje me nenin 17 dhe 19 të LPK-së, vlerësoi kompetencën lëndore të Gjykatës në këtë çështje juridike dhe gjeti se Gjykata Komerciale, Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike nuk është kompetent në pikëpamje lëndore për të gjykuar këtë çështje.

Sipas nenit 13 par.1 nën par. 1.1 të Ligjit për Gjykatën Komerciale (Ligji nr. 08/L-15) përcaktohet se Gjykata Komerciale është kompetente për të gjykuar dhe ka juridiksion ekskluziv për të gjykuar, në Dhomat e Shkallës së Parë dhe Dhomat e Shkallës së Dytë “*kontestet ndërmjet shoqërive tregtare vendore dhe të huaja, si dhe kontestet ndërmjet personave juridikë publikë dhe privat, në lidhje me çështjet e ndërsjella tregtare dhe çështje tjera mes tyre*”.

Meqenëse në rastin konkret paditësi është personi fizik, ndërsa Departamenti për Çështje Ekonomike në kuadër të Dhomave të Shkallës së Parë të Gjykatës Komerciale është kompetent për të vendosur kontestet ndërmjet shoqërive tregtare vendore dhe të huaja, si dhe kontestet ndërmjet personave juridik publik dhe privat, në lidhje me çështjet e ndërsjella tregtare dhe çështje tjera mes tyre, rezulton se kjo çështje nuk bie në kompetencë lëndore të kësaj gjykate.

Ndërsa, duke u bazuar në nenin 12 dhe 20 të Ligjit për Gjykatat (Ligji nr. 06/L-054), në lidhje me nenin 37 dhe 38 par.1 të LPK-së, kompetente për shqyrtimin e kësaj çështje është Gjykata Themelore në Mitrovicë - Departamenti i Përgjithshëm, meqenëse nga regjistri publik i ARBK-së, rezulton që selia e debitorit N.N.T “B&B”, gjendet në territorin e Komunës së Mitrovicës.

Nga sa u tha më lart, gjykata vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi duke u bazuar në nenin 17 dhe 19 lidhur me nenin 387.1 pika (u) dhe nenin 392 pika. (b) të LPK-së.

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS

Dhomat e Shkallës së Parë - Departamenti për Çështje Ekonomike

KE.nr. 349/22, datë 07.02.2024

Gjyqtari
Florent Zeqiri

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij aktvendimi është e lejuar e drejta e ankesës, në afat prej shtatë (7) ditëve, nga dita e pranimi të aktvendimit, në Dhomat e Shkallës së Dytë, në Gjykatën Komerciale të Kosovës, përmes Dhomave të Shkallës së parë të kësaj Gjykate